Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Majlinda Bedrolli	**09.02.2023**	**20.02.2023**	**2023/0055**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me daten: 30.01.2023, OE "Sfinga SH.P.K."- Prishtine, ka parashtruar ankese me nr: 2023/0055, kunder anulimit te aktivitetit te prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Ofrimi i sherbimeve te marketingut dhe maredhenie me publikun per nevojatb e Komunes se Prizrenit" me nr. te prokurimit: "622-22-6816-2-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT. Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, kontratë publike kornizë prej 36 muajsh , lloji i kontratës: shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 180,000.00 €. Nese eshte e perseritur ankesa, te shenohet se lidhur me kete lende eshte nxjerr nje vendim i meparshem i OSHP - se, me Nr. 2022/605 i dt:14.12.2022 Konform nenit 113, 114 te Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotesuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore te OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 1, 6, 7, 56, 59, 62, 69,dhe 72 të LPP-së si dhe nenin 44.7 të Rruopp-së, dhe Vendimi nr.605-2022 i OSHP-së.

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt. 06.07.2022, kurse data e fundit për dorëzim të tenderëve dhe hapja e ofertave ka qenë me dt. 15.08.2022.

Kriter kryesor për dhënie të kontratës ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Vlera e parashikuar e kontratës është 180,000.00 €.

Me dt. 11.01.2023 pas rivlerësimit, AK-ja ka nxjerr NJOFTIM MBI VENDIMIN E

AUTORITETIT KONTRAKTUES PËR ANULIM TË PROCEDURËS SË PRKURIMIT me arsyetimin se "Tenderi anulohet sepse nuk kemi asnjë oferte te përgjegjshme". Arsyeja e AK-së për eliminim tonë, është e njëjtë me arsyen sikurse ne vendimin e datës 10.10.2022:

Fillimisht ju sqarojmë se me dt. 10.10.2022, përmes platformës elektronike e-prokurimi jemi njoftuar me njoftimin mbi vendimin e AK-së, pra me formularin B58, e ku në këtë formular është shënuar se e "Tenderi anulohet sepse nuk kemi asnjë oferte te përgjegjshme " si dhe na ka eliminuar neve duke e shënuar se tenderi juaj është administrativisht i papërgjegjshëm.

Me d.t 14.10.2022 ne kemi parashtruar kërkesën për rishqyrtim ndaj vendimit të AK-së të dt.10.10.2022 me pretendimet tona ankimore se vendimi i AK-së është i pa bazuar dhe se ka vepruar ne kundërshtim me dispozitat ligjore te LPP-së duke na eliminuar neve si OE i përgjegjshëm.

Pas aprovimit të kërkesës për rishqyrtim, AK-ja ka rishqyrtuar vendimin e saj, ndërsa me dt 20.10.2022 përmes e-prokurimit kemi pranuar njoftimin mbi vendimit (formulari B58) ku e na ka eliminuar si OE i papërgjegjshëm si dhe e ka anuluar ne tersi këtë aktivitet të prokurimit me arsyetimin e njëjtë "nuk kemi OE të përgjegjshëm".

Me dt.31.10.2022 ne kemi parashtruar ankesë pranë OSHP-së me pretendimet ankimore se ne jemi OE i përgjegjshëm dhe se eliminimi ynë është bërë pa fakte dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore të LPP-së.

OSHP-ja bazuar edhe në rekomandimet e ekspertit shqyrtues me dt.14.12.2022 ka nxjerr vendimin Nr.605-22, e ku e ka APROVUAR ankesën tone si të bazuar me të gjitha pretendimet tona ankimore, si dhe ka urdhëruar AK-në që të anulohet njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit dhe lënda të kthehet në Rivlerësim.

Ju sqarojmë se arsyet e eliminimit janë të pa qëndrueshme dhe të pa bazuara dhe janë në kundërshtim të plotë me faktet dhe dëshmitë e ofruara nga ne.

Pretendimet tona ankimore ndaj arsyetimit të AK-së do ti sqarojmë në vazhdim: Sa i përket

arsyes së eliminimit se ne nuk e përmbushim kërkesën nr 1 tek Kapaciteti teknik dhe profesional e ku është kërkuar Kërkesë 1. Projektet e natyrës së kontratës realizuara ne tri vitet e shkuara (duke filluar nga koha e publikimit të këtij njoftimi) e vërtetuar nga OE, ku përfshihen titujt e projekteve, numri, data e kontraktimit të standardeve dhe vlerat tyre, vlera minimale e të gjitha projekteve të natyrës së kontratës duhet të jetë jo më e vogël se 180.000,00 € ju sqarojmë se një arsyetim i tillë nuk qëndron dhe është në kundërshtim me faktet e ofruar nga ne. Ne në dosje të tenderit e kemi bashkangjitur dhe ofruar listën e projekteve te realizuara te lëmes së ngjashme dhe natyrës së kontratës dhe vlerës se kërkuar ku në këtë listë janë saktësuar titulli i kontratës, shuma e kontratës, data e përfundimit dhe fituesin si dhe referencat për kryerjen e punëve. Pra ne kemi ofruar një listë të kontratave e ku me këtë listë ne e përmbushim në tërësi kërkesën e dosjes së tenderit, madje e tejkalojmë vlerën e kërkuar.

Dëshmitë dhe kontratat së bashku me referencat e ofruar nga ne jo vetëm që e përmbushin kërkesën në vlerë prej 180.000.00 € por e tejkalojnë vlerën e kërkuar. Nëse AK-ja do ti analizonte në tersi kontratat dhe referencat e ofruar nga ne, të gjitha këto kontrata dhe referenca janë të natyrës së kontratës si dhe janë shërbime që janë kryer ndaj Komunës së Prizrenit për projekte tërësisht të njëjta. Bazuar ne gjendjen faktike vlera totale e kontratave për tre vitet e fundit është 308.233,52 euro , ndërsa vlera e kontratave te natyrës se kërkuare me referenca është 208.434,52 euro, qe tejkalon kërkesën e lartcekur ne FDT.

KRITERET PËR VLERËSIM

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*
Kërkes 1. Projektet e natyrës së kontratës realizuara ne tri vitet e shkuara (duke ?lluar nga koha e publikimit të këtij njoftimi) e vërtetuar nga OE, ku përfshihen titujt e projekteve, numri, data e kontraktimit të standardeve dhe vlerat tyre, vlera minimale e të gjitha projekteve të natyrës së kontratës duhet të jetë jo më e vogël se 180.000,00 € Kërkesa 2. Në kuadër të sta?t duhet të emrohet me vendim menaxheri për këtë projekt I cili duhet të ketë të kryer fakultetin e	**Dëshmia 1 Lista e projekteve te natyrës së kontratës e vërtetuar për tri vitet e fundit nga OE- (e skenuar nga origjinali) për dosien elektronike, , të deshmuara me referenca të cilat dëshmojnë vlerën e shërbimeve dhe natyrën e tyre apo proces verbal të pranimit përfundimtar të shërbimeve. Dëshmia 2. kesën a Diploma e Fakultetit kopje ose çerti?katat adekuate për pozitën e kërkuar, referencat për periudhën e kaluar në profesion së paku për 3**

Arteve drejtimi për dizajn bachelor ose master jo më pak 3 vite pune në profesion Kërkes 3. Sta? teknik që duhet ta ketë operatori ekonomik në përputhje me natyrën e punës dhe kërkesat e komunës janë kështu 3.1 2 Fotograf e profesional I e natyrës së ngjashme me kërkesat e këtij tenderi I e cili duhet të kenë mbaruar fakultetin arteve ose Certi?kata të trajnimeve të kryera për fotogra?. 3.2 1 Tekstshkrues e mbi përmbajtjet e shkresave për media dhe publikime në rrjete sociale I e cila duhet të ketë të kryer fakultetin e gjuhëve shqipe apo angleze bachelor apo master 3.3 1 Editues e I e videove komunale promovouese I e cili duhet të paraqes diplomë të fakultetit të arteve ose Certi?kata të trajnimeve të kryera të fotogra?së 3.4 2 Dizajner e të përmbajtjeve të publikimeve për media dhe rrjete sociale i e të cilët duhet të kenë të kryer fakultetin e arteve drejtimi Dizajn I Komunikimit dhe të ketë përvojë pune së paku 3 vite.	**vite, kontrata e punës ose kontrata e bashkpunimit me OE për këtë projekt. Dëshmija 3.1Dioploma mbi kryerjen e fakultetit arteve ose Certi?kata të trajnimeve të kryera për fotogra?. , 3.2, diploma për fakultetin e gjuhëve shqipe apo angleze bachelor apo master 3.3, diplomë të fakultetit të arteve ose Certi?kata të trajnimeve të kryera të fotogra?së 3.4 Diploma e fakultetit te arteve drejtimi Dizajn I Komunikimit dhe të ketë përvojë pune së paku 3 vite.**

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Duke u bazuar në B58 Njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues të datës 11.01.2023, është konstatuar si në vijim: AK- Komuna e Prizrenit **anulon** ketë aktivitet të prokurimit në mungesë të ofertave të përgjegjshme.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

Vendimi PSH.NR.605/2022, dt.14.12.2022

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **Sfinga SH.P.K.**

Sqarim hyrës: Fillimisht sqarojm se permes sisteni eprokurimi platforma nuk na ka leju mi bart te gjitha pretendimet ankimore qe gjenden në ankesë me gjithatë ne vijim janë dhë të gjitha pergjigjjet pretendimet ankimore. Autoriteti kontraktues Komuna e Prizrenit, ka zbatuar procedurë të hapur, kontratë publike kornizë prej 36 muajsh –shërbim, kriteri i dhënies së kontratës tenderi i përgjegjshëm me Çmimi më te ulët, vlera e parashikuar e kontratës 180,000.00 euro. Pretendimet ankimore kanë të bëjnë kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit dhe mos zbatim të vendimit të PSH.605/22, të datës 14.12.2022.

Përgjigje në pretendimet ankimore (Neni 113 LPP) "Sfinga SH.P.K. –Prizren

Pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës kundrejt pretendimeve ankimore sqarojmë se tani kemi të bëjmë me lëndë të përsëritur, ku palët janë të njëjta dhe eksperti

shqyrtues përmes raportit paraprak të datës 29.11.2022, me numër 605/22 ka dhënë rekomandimin e tij, ku pretendimet e të njëjtit i ka vlerësuar si pjesërisht të bazuara dhe njehërit ka rekomanduar të anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit, ndërsa lënda të **kthehet në rivlerësim**. Kurse, Paneli Shqyrtues me datë 14.12.2022 ka nxjerr vendimin Psh.Nr.605/22 duke e aprovuar ankesën e operatorit ekonomik si të bazuar dhe ka anuluar njoftimin për anulim të aktivitetit të prokurimit, ku obligon AK –Komuna e Prizrenit që lëndën ta kthejë në **rivlerësim**.

2. Eksperti i njëjtë shqyrtues, teknik ose profesional i prokurimit, nëse konstaton se pretendi ankimore janë të njëjta të cilat janë shqyrtuar më parë nga paneli shqyrtues, e njofton me shk panelin shqyrtues dhe palet ne procedure lidhur me këto pretendime ankimore.

Ekspertja shqyrtues sqaron se kjo procedurë e prokurimit ka qenë objekt i shqyrtimit në OSHP sipas ankesës së parashtruar me datë 31.10.2022, ku në bazë të kësaj ankese ishte nxjerr raport i ekspertizës me nr. 605/2022. Në raportin e ekspertit i cili e kishte trajtuar lëndën, i njëjti i kishte propozuar panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues "Sfinga SH.P.K. –Prizren të aprovohet si pjesërisht të bazuaradhe kishte rekomanduar te anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe lënda te **kthehet në rivlerësim**

Andaj, ekspertja shqyrtuese sqaron se Paneli Shqyrtues i ka gjykuar pretendimet e operatorit ekonomik me Vendimin PSH.nr. 605/2022 të datës 14.12.2022 dhe këto pretendime janë "Res Judicata" sipas nenit 16, pika 2 të Rregullores Nr.01/2020, e Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit:

Ekspertja shqyrtuese sqaron se Paneli Shqyrtues përmes vendimit PSH.Nr. 605/2022 të datës 14.12.2022, ka konstatuar se nuk qëndron arsyeja e eliminimit të OE ankues lidhur me referenca, përkatësisht me kërkesën e Kapacitetit Teknik dhe profesional, ku ndër të tjera në këtë vendim është konstatuar se OE "Sfinga SH.P.K. –Prizren ka përmbushur kërkesat e njoftimit për kontratë. Për më tepër, referoju pjesës së shkëputur nga vendimi PSH.Nr.605/2022:

Paneli shqyrtues konstaton se pretendimi ankimor i OE ankues është i bazuar dhe nuk qëndrojnë arsyet e eliminimit të OE. Operatori ekonomik ne këtë rast ka përmbushur kërkesën "Kapaciteti Teknik dhe Profesional" sa i përket realizimit të kontratave në tri vitet e kaluara konform kërkesës në DT/Njoftimin për Kontratë.

Andaj, duke pasur parasysh konstatimin e Panelit Shqyrtues në lidhje me referencat, përkatësisht me kërkesën e Kapacitetit Teknik dhe profesional, ekspertja shqyrtuese konsideron se kjo çështje tanimë është "res judicata" sepse është vendosur në vendimin Psh.Nr.605/2022 të datës 14.12.2022.

Si pretendim ankimor të cilin e ka potencuar OE në ankesë se nuk është respektuar vendimi i Vendimin PSH.nr. 605/2022 të datës 14.12.2022, dhe te merren masa ndaj zyrtarit te prokurimit, ekspertja shqyrtuese sqaron se është në kompetencë të Panelit Shqyrtues të merr apo mos merr masa kundrejt AK-së.

Po ashtu, Operatori ekonomik "Sfinga SH.P.K. –Prizren ka ngritur pretendime ankimore edhe kundrejt ofertës tjerë pjesëmarrëse, përkatësisht kundrejt grupit të operatorit ekonomik "Kreshnik Susuri" B.I Radio Televizioni "Besa"; Aprint Grop SHPK, ku i njëjti është eliminuar nga autoriteti kontraktues, si në letrën standarde të datës 11.01.2021. **Ekspertja shqyrtuese** duke u bazuar në platformën e e-prokurimit, sqaron se nuk ka has në shkresa se grupi i operatorëve ekonomik "Kreshnik Susuri " B.I Radio Televizioni "Besa" ; Aprint Grop SHPK "Berisha Com" kanë paraqitur kërkesë për rishqyrtim pranë AK Komuna e Prizrenit, prandaj vet fakti që i njëjti nuk ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim dhe ankesë në OSHP, është pajtuar me rezultatin e aktivitetit të prokurimit.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që lënda të trajtohet si çështje e gjykuar sipas vendimit paraprak të OSHP-së.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **Sfinga SH.P.K.**

Majlinda Bedrolli